

## **Stilistja shqiptare shkëlqen në Nju Jork**

10 March 2009

Pas diplomimit në të famshmin institut të dizenjimit në Padova të Italisë, Boci hapi një atelier të vetën në Shqipëri. Në vitin 2001 ajo u shpërngul në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilën ajo e quan “toka ime e premtuar” dhe shumë shpejt u bë e njohur në zonën e Detroitit për dizenjimet e saj perfekte, të cilat i shiteshin një klientele të zgjedhur, po aq sa në dyqane të tilla si “Alessandra Bridal”, “Janet Verner” and “Impulse”. Modelet e saj janë prezantuar në “Orët e Detroitit”, po aq sa edhe në revista të modës, ndërkohë që Katerina është stilistja e preferuar e spikereve të lajmeve Lila Lazarus dhe Rhonda Walker.

Zonjusha Boci është përfshirë edhe në shfaqjet e bamirësisë, të organizuara nga fondacioni Rhonda Walker. Ajo ka modeluar edhe fustanin e mbrëmjes për një shërbim fotografik të studios të Fadil Berishës në Nju Jork, për Mis Universin 2006, Zuleyka Rivera dhe fituesen e “Miss Albania”-s, Sadina Alla në paradën e Miss Universe 2007. Në një tjetër “sfilatë” fotografish, këngëtari Fergie admiroi punën e stilistes Boci, ndaj edhe ajo prezantoi yllin e muzikës pop me një xhybe, të cilën ai do ta vishte në një festë në Hollivud. “Unë modeloj për ta bërë një grua të ndjehet femërore, për të ndjerë një fërkim të mëndafshit në lëkurën e saj si dhe për të treguar linjat e saj”, - thotë Katerina Boci.

Në vitin 2007, Katerina Boci hapi studion më të madhe të stilimit në Miçigan. Hapësira prej 1 km katror studio është në dispozicion të klientëve të saj të mençur, për fustane dasme, kokteilesh e mbrëmjeje. Të gjitha veshjet janë të punuara me dorë dhe të prera në bazë të specifikave të klientëve, të bëra enkas për të nxjerrë në pah më të mirën e tyre.

“Katerina është një artiste me energji ngjitëse për krijimtarinë, modelimin dhe vetë jetën”, - thekson botuesi i “”Couture Fashion Eëek”, Andres Aquino. “Pjesmarrja e saj në këtë ngjarje të madhe të modës, me siguri do të sjellë më shumë mirënjohje për këtë stiliste të talentuar, e cila vazhdon të zhvillohet dhe të shkëlqejë në fushën e saj, për të cilën ajo ka pasion të madh”. “Couture Fashion Eëek” dhe “Bridal Fashion Eëek” janë ditë më shumë ngjarje për të prezantuar modele luksi dhe modë të mirë, duke përfshirë edhe veshje mbrëmjesh dhe elegante, veshje nusesh, po aq sa edhe shfaqje aksesorësh. Këto aktivitete përfshijnë klientë të klasit të lartë, VIP-a të ftuar, median si dhe blerës të zgjedhur dyqanesh të dorës së parë. Dy ngjarjet përfshijnë edhe një sërë zbavitjesh si kokteile dhe festash, të cilat do të mbahen në Nju Jork, Palm Beach, Florida dhe qytete të tjera të zgjedhura.

### **Vajza nga Lushnja që gjeti ëndrrën në SHBA**

Stilistja shqiptare, Katerina Boci ka lënë Shqipërinë në mes të vitit 2001, së bashku me dy vajzat, bashkëshortin dhe mamanë e ve, të cilën e quan krahun e vet të djathtë dhe mikeshën me të mirë, për shkak të mbështetjes që i ka dhënë. Ajo jetoi në një apartament me dy dhoma, duke punuar në një restorant italian, ndërkohë që e ëma kujdesej për dy vajzat e saj. Sot ajo shet fustanë për trefishin e shumës së parave me të cilat erdhi në SHBA dhe e gjithë kjo ishte fat për Katerinën. Ajo ishte martuar në vitin 1992, kur ishte 20 vjeç me një oficer policie, burri i saj prej 14 vitesh. Ajo mori dy dëshmi nga një program prestigjioz i Universitetit të Oksfordit në Lushnje, kohë kur dëshiroi të bëhej një diplomate, pa e menduar kurrë se do të bëhej një stiliste. Tashmë, Katerina Boci është një nga stilistet më të lakmuara në Detroit, ndërkohë që është ftuar të marrë pjesë në mbrëmjen më të madhe të Modës, që organizohet në Nju Jork.